



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

**P.nr.3/2018**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - DEGA NË VUSHTRRI - Departamenti i përgjithshëm-Divizioni Penal**, Gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Bahrije Smakolli, në çështjen juridiko-penale kundër të pandehurit M, Gj, nga Vushtrria rr. “,,,,” për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 187 par.1 lidhur me par.3 të KPRK-së dhe veprës penale Kanosje nga neni 185 par 2 të KPRK-së, e në bashkim real me veprën penale si nën pikën I të dispozitiv, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP.II.nr.98/17 e datës 04.01.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor jo - publik të datës 10.07.2020, në praninë e Prokurorit të shtetit Jovo Radoviq, të pandehurit M, Gj,, avokatit mbrojtës me autorizim av. Agim Lushta, pas shpalljes së aktgjykimit me datë 10.07.2020, me datë **13.07.2020** përpiloi, këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**I PANDEHURI: M, Gj**, me pseudonimin M,, nga i ati M,, e ëma Xh, i lindur me datë ,,,, me numër personal ,,,, me vendbanim në Vushtrri, rr. “,,,” ka të kryer shkollën e mesme, zyrtar policor në Mitrovicë, i shkurorëzuar, prind i dy fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, më parë i pa gjykuar shqiptarë, shtetas i Republikës së Kosovës.

### **ËSHTË FAJTOR**

#### **SEPSE:**

**I.** Me datë 18.07.2016 rreth orës 20, në shtëpinë e përbashkët familjare që gjendet në Vushtrri, në rr. “Lidhja e Lezhës”, i pandehuri e ka sulmuar fizikisht bashkëshorten e e tij – të dëmtuarën L. Gj. dhe atë për shkak të një mosmarrëveshje dhe fjalosjes të të dëmtuarës L. që kishte pasur me nënën e tij Xh. dhe motrën K. brenda në shtëpi, aty ndërhyr i pandehuri M. i acaruar ku të dëmtuarën L. e sulmon fizikisht duke përdorur forcën e kapë për krahëve për ta larguar nga shtëpia dhe done ta godasë këtë e ndalojnë babai i tij M. dhe vëllau i të dëmtuarës A. që kishin qenë prezent në ballkonin e shtëpisë

- **Me këtë ka kryer veprën penale, Sulmi nga neni 187 par.1 lidhur me par.3 të KPRK-së**

**II.** Në të njëjtën ditë kohë dhe vend si në pikën I të dispozitivit në gjendje agresive dhe të tensionuar i pandehuri e ka kanosur seriozisht të dëmtuarën bashkëshorten e tij L., me fjalët “dil nga shtëpia sa nuk të kam mbytë”, pastaj i ka paralajmëruar vëllezërit e saj A. dhe A. B. me fjalët “kapne këtë kudër e hupni mos të ju shohë, dilni nga oborri im, ja bëna çka nuk bënë askush”, duke i kërcënuar me fjalë këto që te e dëmtuara L. dhe vëllezërit e saj ka ndikuar që të njëjtit të

vihen në shqetësim, ankth dhe frikë për sigurinë e saj nga i pandehuri, dhe sidomos për faktin që ajo jeton në të njëjtën shtëpi me të pandehurin ndihet e rrezikuar nga ai në çdo moment.

- **Me këtë ka kryer veprën penale, Kanosje nga neni 185 par 2 të KPRK-së të KPRK-së e në bashkim real me veprën penale si nën pikën I të dispozitiv.**

Andaj, gjykata duke u bazuar në dispozitat e nenit, 4, 7, 17, 21, 41, 42, 43, 45, 46, 73, 74, 185, dhe nenit 187 të KPRK-së dhe nenit 365, 450 e 463 të KPPK-së, e

## **G J Y K O N**

**I.** Për veprën penale I e gjykon me **DËNIM ME BURG** në kohëzgjatje prej 6 muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet në qoftë se i pandehuri nuk kryen vepër penale në periudhën verifikuese në kohëzgjatje prej një (1) viti, si dhe

**II.** Për veprën penale 2 e **DËNIM ME GJOBË** në shumë prej pesëqind euro (500 €), i cili dënim do të ekzekutohet 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në rast se i akuzuari refuzon të paguaj këtë dënim me gjobë, atëherë ky dënim me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg, duke i caktuar të akuzuarit për çdo 20 € (njëzet euro) të dënimit me gjobë, nga 1 (një) ditë burgim.

E dëmtuara Lirije Behrami për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullte civil.

**DETYROHET** i pandehuri që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguaj shumën prej tridhjetë euro (30 €).

**DETYROHET** i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej pesëdhjetë euro (50 €).

Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

## **A r s y e t i m**

### **Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar**

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur PP.II.nr.98/17 e datës 04.01.2018, kundër të pandehurit M. Gj. nga Vushtrria rr. “Lidhja e Lezhës” për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 187 par.1 lidhur me par.3 të KPRK-së dhe veprës penale Kanosje nga neni 185 par 2 të KPRK-së, e në bashkim real me veprën penale si nën pikën I të dispozitiv.

Gjyqtari i vetëm gjykues ka pranuar këtë lëndë me datë 05.01.2019, dhe pas pranimit fillimisht ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar për datë 27.03.2019 e cila seancë është shtyrë me kërkesë të pandehurit për arsye se avokati mbrojtës i të pandehurit ka qenë në një gjykim tjetër.

Gjykata me datë 23.04.2019 ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar në të cilën seancë i pandehuri është deklaruar i pafajshëm. I pandehuri përmes avokatit mbrojtës me datë 23.05.2019 ka paraqitur kërkesë për hudhjen e aktakuzës, e cila është refuzuar nga gjykata me aktvendimin Pnr.03/2018 të datë 23.05.2019. I pandehuri përmes avokatit mbrojtës me datë 26.06.20219 ka paraqitur ankesë ndaj vendimit të gjykatës për Pnr.03/2018 të datë 23.05.2019, e cila është refuzuar nga Gjykata e Apelit me aktvendimin PN.nr753/2019 të datë 31.07.2019.

Gjykata me datë 08.10.2019 ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor e cila seancë është shtyrë në mungesë të mbrojtësit dhe të pandehurit, si dhe në bazë të kërkesë së datës 25.09.2019 ka kërkuar që seanca e shqyrtimit gjyqësor të shtyhet për datën 09 mars 2020 për faktin se dëshmitarët A. e A. B., vëllezërit e të dëmtuarës të propozuar nga Prokuroria e shtetit si dëshmitar janë jashtë vendit në Gjermani.

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 22.10.2019 dhe e njëjta është shtyrë për datë 19.11.2019 për faktin se kanë munguar e dëmtuara, dëshmitarët dhe avokati mbrojtës i të pandehurit. Po ashtu edhe kjo seancë është shtyrë për datë 16.12.2019 pasi që e dëmtuara në cilësinë e dëshmitares ka refuzuar të jetë e pranishme në seancë pa prezencën e vëllezërve dhe se në këtë seancë kanë munguar të gjithë dëshmitarët e propozuar nga Prokuroria.

Gjykata me datë 16.12.2019 ka mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor dhe në këtë seancë i pandehuri ka deklaruar se ndihet i pafajshëm, kurse dëshmitari i propozuar nga Prokuroria av. M. T. prindi i të pandehurit i cili pas paralajmërimit nga gjykata se në pajtim me nenin 127 të KPPK është i liruar nga dhënia e dëshmisë, i njëjti për shkaqe shëndetësore ka hequr dorë nga dhënia e dëshmisë, në mungesë të të dëmtuarës – në cilësinë e dëshmitares ka urdhëruar Stacionin Policor në Vushtrri të sjellin me forcë dëshmitaren por të njëjtit e kanë informuar gjykatën se e dëmtuara – dëshmitarja nuk ka qenë në shtëpi.

Gjykata me datë 10.01.20 ka vazhduar shqyrtimin gjyqësor dhe në këtë seancë ka dëshmuar e dëmtuara – dëshmitarja, ndërsa dëshmitarët A. e A. B. kanë munguar.

Gjykata me datë 09.03.2020 ka vazhduar seancën e shqyrtimit gjyqësor dhe në këtë seancë ka dëshmuar i propozuar nga prokuroria A. B. ndërsa ka munguar dëshmitari A. B..

Gjykata me datë 30.06.2020 ka vazhduar seancën e shqyrtimit gjyqësor dhe në këtë seancë ka munguar i pandehuri i cili në bazë të flet kthesës së datës 11.06.2020 është konstatuar se ka ndërruar vendbanim por i njëjti më pas është lajmëruar në gjykata dhe e ka informuar gjykatën se thirrja është nënshkruar nga prindi i ti dhe i njëjti ka probleme shëndetësore.

Gjykata me datë 10.07.2020 ka vazhduar seancën e shqyrtimit gjyqësor dhe në këtë seancë ka dëshmuar dëshmitarja motra e të pandehurit K. T., e propozuar nga avokati mbrojtës edhe pasi paraprakisht është paralajmëruar nga gjykata se është e liruar nga dhënia e dëshmisë në pajtim me nenin 127 të KPPK-së, e njëjta ka pranuar të jap dëshmi dhe pas dëgjimit të saj gjykata ka kaluar në fjalën përfundimtare të palëve dhe ka përfunduar me shqyrtimin gjyqësor duke shpallur njëjtherit edhe aktgjykimin lidhur me këtë çështje penale.

**Pretendimet e palëve gjatë shqyrtimit gjyqësor**

Prokurori i shtetit gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor në fjalën hyrëse ka deklaruar se, i propozon gjykatës që të administrohen provat si në pikën II të aktakuzës, përfshirë dëgjimin e të dëmtuarës në cilësinë e dëshmitares dhe dëgjimin e dëshmitarit M.T. – prindi i të pandehurit, ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se në bazë të dëshmimeve të dhëna gjatë shqyrtimit gjyqësor nga e dëmtuara – dëshmitarja .L Gj.e njëjta ka deklaruar se bashkëshorti ka dashur ta godas dhe e ka shty me duar duke ju drejtuar me fjalët “dil nga shtëpia”, ndërsa sa i përket veprës penale të dytë e njëjta ka deklaruar se i pandehuri ka pasur armë, ndërsa sa i përket mbrojtëses së të pandehuri i njëjti po ju shmangët përgjegjësisë penale, shtrohet pyetja pse vëllezrit e të dëmtuarës A. e A. B. kanë ardhur në shtëpinë e të pandehuri, ky fakt tregon mjaftueshëm se të njëjtit kanë dashur të bëjnë bisedë me dhëndrin e tyre në lidhje me mosmarrëveshjet të cilat i ka pasur i i pandehuri me të dëmtuarën, por i pandehuri ka refuzuar. Dëshmitari A. B. ka deklaruar se ka dëgjuar një zhurmë dhe zërin e dhëndrit të tij të pandehurit. Po ashtu prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se lidhur me të njëjtën çështje penale pran kësaj gjykate është shqiptuar Urdhëri Ndëshkimor ndaj të pandehurave K.e Të. dhe Xh. T. për veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par 1 pika 1.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që të pandehurin ta shpall fajtorë dhe ta dënoj sipas ligjit për veprat penale të cekuar, si dhe i ka propozuar gjykatës të merrë parasysht si rrethanë lehtësuese, se veprat penale janë kryer para katër (4) viteve dhe se i pandehuri nuk është i dënuar më parë.

E dëmtuara ka munguar në seancën e parë të shqyrtimit gjyqësor kur është paraqitur fjala hyrëse si dhe në seancën e vazhdimit të shqyrtimit gjyqësor kur është paraqitur fjala përfundimtare e palëve edhe pse ka qenë e ftuar në mënyrë të rregullte dhe nuk ka dhënë arsye për mungesën e saj.

Mbrojtësi i të pandehurit me autorizim në fjalën hyrëse të shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se gjatë shqyrtimit gjyqësor do të vërtetohet se i mbrojturi im është i pafajshëm për veprat penale të cilat i vihen në barrë, ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor është vërtetuar se i mbrojturi im nuk kreu veprat penale të cilat i vihen në barrë. Nga shkresat e lëndës si dhe dëgjimit të dëshmitarëve mund të vërehet se ka kundërthënë në dëshminë e të dëmtuarës në cilësinë e dëshmitares, dëshmitarit A. dhe A. B., derisa e dëmtuara në deklarimet e dhëna në polici me datë 18.07.2016, në pyetjen se a keni pasur kontakte fizike sot gjatë kacafytjes e dëmtuara është përgjigjur se nuk ka pasur kacafytje me të pandehurin, mirëpo gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se në momentin kur e kanë shtyrë K. dhe Xh. T. i të njëjtën e ka shty edhe i mbrojturi im. Karakteri i çështjes që lidhet me mospërputhjet mund të ketë rëndësi për vlerësimin e besimit të dëshmitares, kjo vërtetohet edhe nga dëshmia e dëshmitarit A. B. i cili në polici ka deklaruar se i mbrojturi im nuk e ka sulmuar fizikisht të dëmtuarën vetëm se ju ka thënë “kapne motrën dhe dilni jashtë mos të ju shohë më këtu”. Sa i përket veprës penale të kanosjes në qoftë se fjala “kapne motrën dhe dilni jashtë mos të ju shohë më këtu”, konsiderohet si kërcënim atëherë çdo fjalë mund të ketë edhe konotacion, pasi që thënia ka qenë normale në atë gjendje kritike pasi që e dëmtuara ka qenë e alivanosur pas shtyrjes së K. dhe Xh. T. e cila është vërtetuar me Urdhëri Ndëshkimor P.nr.73/2017 të datës 23.03.2017 i shqiptuar ndaj të pandehurave K. T.dhe Xh. T. për veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par 1 pika 1.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Sa i përket deklarimit të dëmtuarës se ditën kritike i mbrojturi im e ka nxjerrë armën nga brezi kjo nuk është dëshmuar edhe nga dëshmitarët A. dhe A. B. dhe mund të konstatohet nga deklarimet e tyre se i mbrojturi im nuk e nxjerrë revolen nga

brezi. Përmbledhja e provave që janë prezantuar nuk përmbajnë hollësi, saktësi dhe besueshmëri përtej dyshimit të bazuar mirë dhe i propozoj gjykatës që në pajtim me nenin 364 par 1 pika 1.3 të KPPK-së të sjellë aktgjykim lirues ndaj të mbrojturit tim.

I pandehuri në fjalën hyrëse dhe në fjalën përfundimtare të shqyrtimit gjyqësor në tërësi e ka mbështetur fjalën e avokatit mbrojtës.

### **Provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor**

Gjykata me rastin e mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në pajtim me nenin 7 të KPPK-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit në pajtim me ligjin, më vëmendje të plotë dhe me përkushtim profesional, dhe me përkujdesje vërtetoi faktet kundër të akuzuarit si dhe faktet në favor të tij duke i mundësuar të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të mbrojtjes, në vazhdim janë të shtjelluara provat e administruara, përfshirë:

### **Provat personale**

- Dëgjimin e të dëmtuarës në cilësinë e në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 10.01.2020, ka deklaruar se ditën kritike të datë 18.07.2016 në shtëpinë ku ka jetuar me bashkëshortin, fëmijët e tre, prindërit e bashkëshortit dhe motra e bashkëshortit kanë ardhur vëllezërit e saj A. B. dhe A. B., për të biseduar me të pandehurin për mosmarrëveshjet që ne kemi pasur, dhe më pa vjehrra ime dhe kunata ime më kanë thënë se pse i ke thirre vëllezërit dhe ti po don me na bë belanë, dhe më pas më kanë ofenduar me fjalët „ se ti je rrospi, dhe më pas djali i sj K. ju ka thënë mos i bërtitni mamit, mami nuk ka faj, më pas vjehrra ime dhe kunata ime më kanë shtyrë shkallëve dhe më pas kam bërtitur dhe jam shtyrë me to dhe ka ardhur vëllau im A., vjehrra im M. si dhe i pandehuri. Vëllau im më ka kapur për flokë dhe më ka goditur me shuplaka dhe më ka thënë se pse po bëhesh me to dhe pastaj unë kam bërtitur dhe i kam treguar se çfarë më kanë thënë ato, në ato momente i pandehuri ka nxjerrë revolen nga brezi dhe fillimisht na ka thënë „ dilni nga shtëpia se ju vras,, dhe më pas e ka thirre policinë me arsyetimin se është ndër i kërcënuar, poashtu i pandehuri ka dashur të më godas por i njëjti ka arritur vetëm të më shtyjë ndërsa motra e tij më ka shtyrë shkallëve dhe nga aty kam humbur vetëdijen deri sa kanë ardhur policia. E njëjta ka deklaruar se me të pandehurin në vazhdimësi kanë pasur konflikte për arsye se i njëjti ka dalë me femra tjera dhe nuk i ka interesuar fare për të.

- Dëgjimin e dëshmitarit A. B., i cili në seancën e vazhdimit të shqyrtimit gjyqësor të datës 09.03.2020 ka deklaruar se pasi që e ka marrë vëllain e tij A. e ka thirre në telefon dhëndërinë e tij M. për të dalë me pi kafe në qytet për të diskutuar për mosmarrëveshjet që i njëjti ka me motrën por i njëjti ka refuzuar dhe ne kemi shkuar në shtëpinë e ti. Fillimisht jemi ulur në ballkonin e shtëpisë dhe kemi ndejë me prindin e të pandehurit ndërsa i pandehuri ishte duke rregulluar diçka në kulm dhe pas 15 minutave ka zbritur poshtë, më pas kemi dëgjuar një bërtitme të pazakontë dhe prindi i të pandehurit është ngritur në këmbë dhe më pas edhe unë jam ngritur në këmbë dhe e kam pyetur motrën time se pse po bërtet pa lidhje, e njëjta ju ka thënë se vjehrra dhe kunata po i thonë pse i ke thirre vëllezërit. I pandehuri më pas nga oborri ka ardhur në ballkon dhe i është drejtuar me fjalët fyese motrës ish bashkëshortes së saj, ne fjalët “çka ka kjo rrospi, magjupe”, dhe më pas kam insistuar të uli tensionet të cilat kanë qene edhe të

mëhershme, më pas ka ndodhur një tollovi në mes të motrës sime, vjehrrës dhe kunatës së saj, babait të tij dhe unë kam qenë në mes, i pandehuri ka ndërhyrë dhe e ka kapur motrën time ish bashkëshorten e tij për dore dhe i ka thënë dilni nga shtëpia dhe mos të ju shohë më, ndërsa mua më ka thënë se çka deshtë që ke ardhur këtu dhe unë i jam përgjigjur se kjo është arsyeja që ta kam thirrë me pi kafe në qytet e të bisedojmë si njerëz, e di që nëna e të pandehurit e ka shtyrë të njëjtin dhe neve na ka thënë ikni nga këtu ndërsa i pandehuri kur është ofruar afër kauçit të ballkonit ka vendosur dorën në armë dhe na ka thënë „ dilni nga këtu mos të ju shohë më, “mua vëllait tim Albertit dhe motrës sime ish bashkëshortes së tij”. Më pas kanë ardhur policia te shtëpia e të pandehurit kanë hyrë brenda dhe dikush prej tyre e ka kapur për dore motrën e rrëzuar dhe e kanë dërguar në ambulancë.

- Leximin e deklaratës së dëshmitari të dhënë në polici pasi që palët në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 10.07.2020 nuk e kanë kundërshtuar, i cili ka deklaruar se pasi që e ka marrë vëllain e tij A. i cili e ka thirrë në telefon dhëndërinë e tonë M. për të dalë me pi kafe në qytet për të diskutuar për mosmarrëveshjet që i njëjti ka me motrën por i njëjti ka refuzuar dhe ne kemi shkuar në shtëpinë e ti. Fillimisht jemi ulur në ballkonin e shtëpisë dhe kemi ndjetë me prindin e të pandehurit dhe më pas kam dëgjuar një bërtimë të Mustafës duke thënë “kapne motren dilni jashtë dhe ecni” pastaj prindi i M. M. e ka kapur motrën dhe e ka shty për ta qitur jashtë, dhe se në momentin e dhënies së deklaratës i njëjti në pyetjen e policisë se a ke diçka për të shtuar ka thënë kam por nuk po ndihem mirë.

- Dëgjimin e dëshmitares K.T., e cila në seancën e vazhdimit të shqyrtimit gjyqësor të datës 10.07.2020 ka deklaruar se ditën kritike të datës 18.07.2016 në shtëpinë e tyre ka qenë me Nënëën ndërsa vëllau M. ka qenë në kulm të shtëpisë duke rregulluar diçka, më pas kanë ardhur vëllezërit e kunatës, kunata ka hy brenda ku ishim ne dhe pasi që nëna e pyeti kush ka ardhë ajo është përgjigjur se vëllezërit dhe çka po të intereson ty dhe më pas e ka shtyrë nënën. Ajo pastaj ka filluar të bërtas dhe ka thënë se nëna-vjehrra po më pyet se për çka kanë ardhë dhe pasi që nuk është ndalur duke bërtitur vëllau i saj A. e ka goditur me shuplakë dhe se i pandehuri M. nuk e ka shtyrë të dëmtuarën, dhe se njëjta ka deklarua se vëllau i saj nuk ka pasur probleme në të kaluarën me dëmtuarën. E njëjta ka deklaruar se është dënuar me gjobë ajo dhe nëna e saj për dëmtimet që ia kanë shkaktuar të dëmtuarës. Dhe se arsyeja e thirrjes së policisë nga vëllau i saj M. ka qenë se kunata L. është alivanosur dhe se nuk e dinim arsyen pse kanë ardhur vëllezërit e saj.

- I pandehuri në seancën e vazhdimit të shqyrtimit gjyqësor është mbrojtur në heshtje duke mbetur pran deklarimeve të dhëna në fazën e hetimeve, i cili kishte deklaruar se, në ditën kritike kishte dëgjuar bashkëshorten e tij L. duke i bërtitur nënën së tij dhe e kishte tërhequr atë për krahu duke i thënë „ se kush i kishte thirrur vëllezërit e saj,, dhe nuk kishte dashur të ndërhyjë duke e njohur karakterin e gruas së tij, kishte kërkuar nga vëllau i saj A. që të ndalonte atë por që ishte e pamundur, dhe se e njëjta është vërsulur në drejtim dhe kishte zgjatur duart për ta grithur në fytyrë por që i njëjti kishte arritur të largohej, dhe duke parë situatën i njëjti kishte thirrë policinë për ndihmë, dhe bashkëshortja e tij L. me të vërejtur kishte filluar të bëjë skena ashtu siç e kishte shprehur dhe se ishte shtrirë në pallton e çimentos para shkallëve, dhe se i njëjti – i pandehuri nuk pranon se ka pasur kontakt fizik apo kanosje ndaj bashkëshortes së tij L. Gj. dhe se edhe në të kaluarën ka pasur probleme e të njëjtën iu kushte treguar familjarëve të saj por të njëjti i kanë thënë se nuk kanë çka ti bëjnë veç me mbytë.

## **Provat materiale**

- Raportin policor të Njësisë së hetimeve – Vushtrri të datës 18.07.2016 ku është përshkruar rasti se si është njoftuar policia për rastin nga i pandehuri M. Gj. se si i është dhënë ndihma mjekësore të dëmtuarës, si është marrë deklarata e të dëmtuarës në prezencë të qendrës për punë sociale dhe inspektoratit policor pasi që i pandehuri ishte policë, se si gjatë gjithë intervistës viktima ankohej në dhimbje të trupit dhe në kokë dhe herë pas here edhe qante, dhe se e njëjta kishte kërkuar që të vizitonte mjekun pasi që shihej se kishte lëndime të dukshme trupore, dhe për këto lëndime të vërejtura është fotografuar nga ana e policisë.

- Nga mesazhet e dërguar nga i pandehuri në drejtim të doktorit, i njëjti ka kërkuar që nga i cili është kërkuar me këqyrë mirë se mos po ja ndërrojnë raportin me qëllim të ndryshimit të gjendjes, me arsyen se e njëjta është rrahur nga vëllau i vetë. Më pas doktori është përgjigjur se unë e kryej punën në mënyrë profesionale në pajtim me ligjin dhe ka kërkuar nga i pandehuri që mos ti dërgojë mesazhe të kësaj natyre. I pandehuri është përgjigjur se vetëm atë gjë po e kërkoj duke aluduar se një policë i ka thënë që nuk është kontrolluar si duhet e dëmtuara.

- Raportin mjekësor të datës 18.07.2016 të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Vushtrri është përshkruar se si pacientja është sjellë në përcjelljen e policisë për herën e dytë brenda një nate dhe ka kërkuar ndihmë mjekësore dhe te pacientja është vërejtur kontuzione në krahun e djathtë dhe të majtë dhe gërvishtje në dorën e djathtë në regjionin para-kraharorit, për përcaktimin e shkallës dhe natyrës së lëndimeve është kërkuar të bëhen nga mjeku ligjor.

- Aktvendimin C.nr.265/16 të lëshuar me datë 29.07.2016 me të cilin është aprovuar kërkesa për urdhër mbrojtje e ushtruar nga Zyra për mbrojtje dhe ndihmë të viktimave dhe urdhëri për mbrojtje më të cilin është urdhëruar dhe i është ndaluar M. Gj. të kryej ose kërcënojë se do të kryej ndonjë veprë të dhunës në familje dhe atë dhunë fizike, shqetësim, presion fizik ndaj palës së mbrojtur L. B.

- Vështrimin e foto-dokumentacionit 6 fotove ku shihet në foton 2 gërvishtja e dorës së djathtë e viktimës, në foton 3 ku shihet krahu i djathtë i viktimës i skuqur, foto 4 ku shihet krahu i majtë i viktimës me një gërvishtje, foto 6 ku shihet një skuqje në ballin e viktimës nga ana e majtë

## **Gjetjet e gjykatës lidhur me faktet**

### **Faktet jokontestuese**

- Është fakt jo kontestues se i pandehuri dhe e dëmtuara në ditën kritike të datës 18.07.2016 kanë qenë bashkëshortë në mes veti, dhe kanë jetuar në bashkësi qe 13 vite dhe nga kjo martesë kanë dy fëmijë, këtë fakt nuk e kanë kontestuar as palët gjatë këtij procesi gjyqësor,
- Është fakt jokontestues se vëllezërit e të dëmtuarës A. e A. B. me datë 18.07.2016 kanë shkuar në shtëpinë e dhëndrit të tyre për të diskutuar për mosmarrëveshjet që kanë pasur

në vazhdimësi i pandehuri dhe e dëmtuara, këtë fakt nuk e kanë kontestuar as palët gjatë këtij procesi gjyqësor.

Faktet e lartcekura nuk janë kontestuar nga palët. Përveç kësaj faktet vërtetohen edhe nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor që janë pjesë e kësaj lënde penale.

### **Faktet kontestuese**

- Është fakt kontestues se i pandehuri e ka sulmuar të dëmtuarën me datë 18.07.2016 dhe në po të njëjtën ditë e ka kanosur të dëmtuarën.

Ky fakt është kontestuar nga ana e mbrojtësit të të pandehurit në fjalën hyrëse, gjatë shqyrtimit gjyqësor, në fjalën përfundimtare dhe nga i pandehuri me rastin e marrjes në pyetje në fazën e hetimeve.

### **Vlerësimi i provave nga gjykata**

Gjykata pas prezantimit të provave, plotësisht dhe përtej dyshimit të bazuar, ka vërtetuar gjendjen faktike si në dsipozitiv të aktgjykimit. Këtë gjendje faktike, gjykata e vërtetoi në bazë të:

- deklaratës së të dëmtuarës - dëshmitares, L. B. ish bashkëshortes së të pandehurit, e cila gjatë shqyrtimit gjyqësor veç tjerash ka deklaruar se, i pandehuri ka nxjerrë revolen nga brezi dhe fillimisht ju ka thënë të dëmtuarës dhe vëllezërve të saj “dilni nga shtëpia se ju vras” dhe se i njëjti ka dashur ta godas të dëmtuarën por i njëjti ka arritur vetëm ta shtyjë të dëmtuarën, dëshmisë së dhënë nga dëshmitari A. B. i cili gjatë shqyrtimit gjyqësor veç tjerash ka deklaruar se, i pandehuri ka ndërhyrë dhe e ka kapur motrën e tij, ish bashkëshorten e tij për dorë dhe më pas ka vendosur dorën në armë dhe ju ka thënë “dilni nga këtu mos të ju shohë më”.

- Dëshmisë së dhënë nga dëshmitari A. B. në fazën e hetimeve, pasi që palët nuk e kanë kundërshtuar leximin e saj, veç tjerash ka deklaruar se, në ditën kritike të datës 18.07.2016 ka dëgjuar një bërtitme të M. duke thënë “kapne motren dilni jashtë dhe ecni”.

Gjykata i vlerësoi dhe nga deklaratat e dëshmitarëve bindëse dhe reale dhe në pajtim edhe me provat materiale, përfshirë:

- Raportin policor të Njësisë së hetimeve – Vushtrri të datës 18.07.2016 ku është përshkruar rasti se si është njoftuar policia për rastin, se si i është dhënë ndihma mjekësore të dëmtuarës, si është marrë deklarata e të dëmtuarës në prezencë të qendrës për punë sociale dhe inspektoratit policor pasi që i pandehuri ishte policë, se si gjatë gjithë intervistës viktime ankohej në dhimbje të trupit dhe në kokë dhe herë pas here edhe qante, dhe se e njëjta kishte kërkuar që të vizitonte mjekun pasi që shihej se kishte lëndime të dukshme trupore, dhe për këto lëndime të vërejtura është fotografuar nga ana e policisë.

- nga mesazhet e dërguara nga i pandehuri në drejtim të doktorit, i njëjti ka kërkuar që nga i cili është kërkuar me këqyrë mirë se mos po ja ndërrojnë raportin me qëllim të ndryshimit të gjendjes.



- Raportin mjekësor të datës 18.07.2016 të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Vushtrri ku është përshkruar se si pacientja është sjellë në përcjelljen e policisë për herën e dytë brenda një nate dhe ka kërkuar ndihmë mjekësore dhe te pacientja është vërejtur kontusione në krahun e djathtë dhe të majtë dhe gërvishtje në dorën e djathtë në regjionin para-kraharorit, për përcaktimin e shkallës dhe natyrës së lëndimeve është kërkuar të bëhen nga mjeku ligjor.

- Aktvendimin C.nr.265/16 të lëshuar me datë 29.07.2016 me të cilin është urdhëruar dhe i është ndaluar Mustafa Gjonit të kryej ose kërcënojë se do të kryej ndonjë veprë të dhunës në familje dhe atë dhunë fizike, shqetësim, presion fizik ndaj palës së mbrojtur L. B.

- Vështrimin e foto dokumentacionit 6 fotove ku janë evidentuar lëndimet e pësura nga e dëmtuara,

Kjo gjykatë, konsideron se përtej çdo dyshimi të bazuar, është vërtetuar plotësisht gjendja faktike, si në dispozitiv të aktgjykimit dhe se në veprimet e të pandehurit, manifestohen të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale Sulmi nga neni 187 par.1 lidhur me par.3 të KPRK-së për faktin se i pandehuri kishte përdorur forcën ndaj të dëmtuarës duke e kapur për dore dhe duke e shtyrë, si dhe veprës penale Kanosje nga neni 185 par 2 të KPRK-së, pasi që i pandehuri e kishte vendosur dorën në armë të cilën e kishte në brezë dhe seriozisht i kishte kanosur të dëmtuarën.

Gjykata në pajtim me nenin 348 të KPPK-së në seancën e vazhdimit të shqyrtimit gjyqësor të datës 09.03.2020 ka aprovuar kërkesën e avokatit mbrojtës të të pandehurit për dëgjimin e dëshmitares K. T. – motra e të pandehurit.

Për gjykatën deklarata e dëshmitares K. T. të dhënë në seancën e vazhdimit të shqyrtimit gjyqësor të datës 10.07.2020 ka qenë subjektive dhe kundërthënëse në raport me deklaratën e dhënë në fazën e hetimeve dhe të njëjtës nuk i fali besimin.

Për gjykatën deklarata të pandehurit në fjalën hyrëse dhe fjalën përfundimtare dhe në fazën e hetimeve ishte, kontestuese, jo e plotë, jo bindëse, jo konsistencë dhe kishte për qëllim shmangien nga përgjegjësia penale dhe të njëjtës gjykata nuk ja fali besimin.

### **Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit**

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh se vepra e parë penale është e sanksionuar me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet, ndërsa vepra penale e dytë është sanksionuar me gjobë ose me burgim deri në një vit, andaj duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, kjo gjykatë si rrethanë rënduese ka gjetur shkallën e përgjegjësisë penale, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur, prezencën e dhunës ndaj viktimës së ndjeshme me rastin e kryerjes së veprës penale, ndërsa si rrethanë lehtësues se i njëjti më parë nuk ka kryer veprë penale, nuk e ka përsëritur veprën penale si dhe faktin se i njëjti është mbajtur i familjes dhe përkujdeset për fëmijët e tij.

Gjykata duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se, edhe me këtë dënim të shqiptuar ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i dënimit, që të parandalohet kryerësin nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen, që i pandehuri në të ardhmen të ketë kujdes të shtuar, që të mos bie në kundërshtim me ligjin, dhe t'i parandalohet personat e tjerë nga kryerja e veprave penale.

### **Arsyet lidhur me shpenzimet e procedurës dhe kompensimin e viktimave të krimit**

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 6 paragrafi 1 pika 1.5 dhe nenin 39 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 05/L-36 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450 par 2 nën par 2.6 të KPPK-së.

### **Arsyet lidhur me kërkesën pasurore juridike**

Vendimin lidhur me kërkesën pasurore juridike, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 463 par 2 të KPPK-së, pasi që pala e dëmtuar nuk ka prezantuar në seancën e vazhdimit të shqyrtimit edhe pse ka qenë e ftuar me rregull.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartshënuara ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI**  
**Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal**  
**P.nr.03/2020, datë: 13.07.2020**

**Procesmbajtësja**

**Bahrije Smakolli**

**GJYQTARI**

**Agron Maxhuni**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej pesëmbëdhjete (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimin të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.